



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 341 prot.

Tiranë, më 28.02.2025

Vendim

Nr. 12 datë 28.02.2025

Për miratimin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2024, programin dhe prioritet e veprimtarisë të saj për vitin 2025, disa shtesa dhe ndryshime në Statut dhe miratimin për fillim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim në titullin *akademik* dhe rishpallje e një vendi për titullin *akademik*

Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 28 shkurt 2025, zhvilluar sipas rendit të ditës (bashkëngjitur), me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të institucioneve sipas nenit 28, pika 2 e Statutit të ASH;

Pas verifikimit të të pranishmëve fizikisht dhe *on-line*, si dhe të plotësimit të *kuorum*-it sipas parashikimit në Statut (bashkëngjitur);

Pas dëgjimit të raportit për vitin 2024 si dhe programin e prioritet për vitin 2025 të ASH e të njësive të përhershme, paraqitur nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave (bashkëlidhur) e diskutimeve për to;

Në mbështetje të vendimit të Bordit të drejtorëve dhe Kryesisë nr. 10, datë 14.02.2025 (bashkëlidhur);

Në mbështetje të vendimit të Kryesisë nr. 8, datë 12.02.2025 *Për fillim procedure për avancim në titullin "akademik" dhe rishpallje e një vendi për titullin akademik* (bashkëlidhur);

Me votim të hapur Asambleja,

Vendosi:

1. Të miratojë raportet e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave, të njësive kërkimore të përhershme e të përkohshme pranë ASH-së, për vitin 2024 (bashkëlidhur);
2. Të miratojë shpërndarjen e buxhetit për Akademinë e Shkencave dhe njësitë e përhershme të kërkim-studimit të albanologjisë, për vitin 2025 (bashkëlidhur);
3. Të miratojë projektet shkencore për vitin 2025 (bashkëlidhur);
4. Të miratojë në parim veprimtaritë shkencore të parashikuara për vitin 2025 (bashkëlidhur);
5. Të miratojë në parim veprimtarinë botuese të Akademisë së Shkencave (bashkëlidhur);
6. Të miratojë propozimet për plotësimin e ndryshimeve të Statutit sipas vendimit 10, datë 14.2.2025, të Bordit të drejtorëve dhe Kryesisë (materiali bashkëlidhur);
7. Të miratojë vendimin e Kryesisë nr. 8, datë 12.02.2025 *Për fillim procedure për avancim në titullin akademik dhe rishpallje e një vendi për titullin akademik;*
8. Për miratimin e këtij vendimi ngarkohen: Kryesia e ASH, sekretari shkencor i ASH, kryetarët e seksioneve, kryetarët e komisioneve të përhershme të ASH, drejtuesit e njësive të përhershme të kërkim-studimit, drejtuesit e njësive të përkohshme të kërkim studimit dhe kancelari.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Tiranë, më 24.02.2024

Rend dite

Për mbledhjen e Asamblesë

Referuar nenit 25, pika 1, 2 dhe 3 të Statutit, mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave do të mbahet më datë 28 shkurt 2025, ora 11.00, në sallën “A. Buda”, me këtë rend dite:

- 1. Paraqitje e raportit përmbledhës të veprimtarisë vjetore të Akademisë së Shkencave për vitin 2024.**
- 2. Programi dhe prioritet e veprimtarisë për vitin 2025.**
- 3. Njohje me VKA nr. 8, datë 12.2.2025 “Për fillim procedure për avancim në titullin *akademik* dhe rishpallje e një vendi për titullin *akademik*.”**
- 4. Miratim i ndarjes e buxhetit të AShSh-së për vitin 2025 dhe disa ndryshime në Statutin e ASh, të miratura në parim nga Bordi i drejtorëve dhe Kryesia, me vendimin nr. 10, datë 14.2.2025.**